

URDHËR
Nr. 977, datë 19.11.2024

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 39, DATË 24.1.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHETËTIN E MALIT TË ZI” DHE URDHËRIT NR. 525, DATË 10.7.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHETËTIN E BULLGARISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 39, datë 24.1.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Malit të Zi” dhe urdhrit nr. 525, datë 10.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Murtajes Afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj